

20221221690

Në bazë të nenit 23-b paragrafit 12 të Ligjit për tregti ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 16/04, 128/06, 63/07, 88/08, 159/08, 20/09, 99/09, 105/09, 115/10, 158/10, 36/11, 53/11, 148/13, 164/13, 97/15, 129/15, 53/16, 120/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 77/21, 215/21 dhe 295/21) Ministri i Ekonomisë solli

RREGULLORE PËR FORMËN DHE PËRMBAJTJEN E FORMULARIT TË KËRKESËS PËR LËSHIMIN E LICENCËS PËR SHITJE TË PIJEVE ALKOOLIKE, FORMËN DHE PËRMBAJTJEN E FORMULARIT TË LICENCËS PËR SHITJE TË PIJEVE ALKOOLIKE DHE FORMËN, PËRMBAJTJEN DHE MËNYRËN E MBAJTJES SË REGJISTRIT TË LICENCEVE TË LËSHUARA DHE TË REVOKUARA

Neni 1

Me këtë rregullore përshkruhet forma dhe përmbajtja e formularit të kërkesës për lëshimin e licencës për shitje të pijeve alkoolike, forma dhe përmbajtja e formularit të licencës për shitje të pijeve alkoolike dhe forma, përmbajtja dhe mënyra e mbajtjes së regjistrit të licencave të lëshuara dhe të revokuara.

Neni 2

Kërkesa për lëshimin e licencës për shitje të pijeve alkoolike dorëzohet në formular në formatin A-4, në letër me ngjyrë të bardhë.

Forma dhe përmbajtja e formularit të kërkesës nga paragrafi 1 i këtij neni janë dhënë në Shtojcën 1, e cila është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

Neni 3

Licenca për shitje të pijeve alkoolike lëshohet në formular në formatin A-4, në letër të veçantë me ngjyrë gri.

Forma dhe përmbajtja e formularit të licencës nga paragrafi 1 i këtij neni janë dhënë në Shtojcën 2, e cila është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

Neni 4

Regjistri i licencave të lëshuara dhe të revokuara për shitje të pijeve alkoolike mbahet në formë elektronike në një dokument Excel.

Forma dhe përmbajtja e regjistrit nga paragrafi 1 i këtij neni jepen në Shtojcën 3, e cila është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

Neni 5

Me ditën e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet Rregullorja për formën dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës për lëshimin e licencës për shitje të pijeve alkoolike, formën dhe përmbajtjen e formularit të licencës për shitje të pijeve alkoolike dhe formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit të licencave të lëshuara dhe të revokuara ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 184/19).

Neni 6

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e nesërme nga dita e publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

Nr. 11 – 925/3

11 maj 2022

Shkup

Ministri i Ekonomisë,
Kreshnik Bekteshi, d.v.

Nr.arkivor dhe data

Shtojca 1

DREJTUAR MINISTRISË SË EKONOMISË
-Sektori për bashkëpunim tregtar ndërkombëtar

K Ë R K E S Ë
PËR LËSHIMIN E LICENCËS PËR SHITJE ME PAKICËTË PIJEVE ALKOOLIKE

Nga _____

(Emri dhe selia e subjektit)

Kërkojmë të na lëshohet Licencë për shitje me pakicë të pijeve alkoolike për objektin e shitjes me pakicë:

Shënoni llojin e kërkesës me

Kërkesës për lëshimin e licencës i janë bashkëlidhur dokumentet e mëposhtme:

- Gjendja origjinale aktuale e tregtarit me pakicë, lëshuar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- fletëpagesa origjinale për kompensim të paguar në shumë prej 20.000 denarë dhe
- fletëpagesa origjinale për tarifë administrative të paguar në shumë prej 50 denarë.

Kërkesës për vazhdimin e licencës së tregtarit me pakicë që ka deri në tre objekte shitjeje i bashkëlidhen dokumentet e mëposhtme:

- fletëpagesa origjinale për kompensim të paguar në shumë prej 5.000 denarë dhe
- fletëpagesa origjinal për tarifë administrative të paguar në shumë prej 50 denarë.

Kërkesës për vazhdimin e licencës së tregtarit me pakicë që ka më shumë se tre objekte shitjeje i bashkëlidhen dokumentet e mëposhtme:

- fletëpagesa origjinale për kompensim të paguar në shumë prej 0.05% të xhiros së përgjithshme të realizuar nga tregtia me pakicë e realizuar në vitin paraprak,
- pasqyrë e shkurtuar nga llogaria vjetore e lëshuar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- dëshmi e të ardhurave të realizuara nga tregtia me pakicë, nëse realizon të ardhura për arsye të tjera,
- fletëpagesa origjinale për kompensim të paguar në shumë prej 15.000 denarë dhe
- fletëpagesa origjinale për tarifë administrative të paguar në shumë prej 50 denarë.

Telefoni dhe personi për kontakt

Personi përgjegjës

(emri dhe mbiemri)



Republika e Maqedonisë së veriut

Ministria e ekonomisë

Në bazë të nenit 23-b paragrafi 1 nga Ligjit për tregti, Ministri i ekonomisë lëshon:

LICENCË

PËR SHITJE TË PIJEVE ALKOOLIKE

për

(emri i tregtarit me pakicë i cili kryen shitje të pijeve alkoolike)

(selia afariste e tregtarit me pakicë)

(adresa e objektit të shitjes)

Licenca vlen për periudhë dy vjeqare.

Nr. Regj. _____

MINISTËR I EKONOMISË

Nr. _____

_____ viti

Shkup

Nënshkrimi

V.V.

SHTOJCA 3

Republika e Maqedonisë së Veriut
Ministria e Ekonomisë

**Regjistër
i licencave të lëshuara dhe të revokuara për shitje të pijeve alkoolike**

faqe e kopërtinës

Numri rendor	Numri arkivor i kërkesës	Data e dorëzimit të kërkesës	Numri i regjistrimit të licencës	Data e lëshimit të licencës	Emri i tregtarit me pakicë	Numri unik anë i subjektit	Selja afariste e tregtarit me pakicë	Adresa e objektit të shijës	Numri i aktvendimit për revokim të licencës	Data e aktvendimit për revokim të licencës	Telefoni	e-mail	Vërejtje
1	2	3	4	5	6	7	8	9	0	11	12	13	14